

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Po studiojmë risqet që mund të sjellë në mjedis"/ Rama nga SHBA: Projekti i Sazanit dhe Zvërnecit, të j ashtëzakonshëm për ekonominë shqiptare Gazeta Shqip
ADRESA	https://gazeta-shqip.com/aktualiteti/po-studiojme-risqet-qe-mund-te-sjelle-ne-mjedis-ram a-nga-shba-projekti-i-sazanit-dhe-zvernecit-te-jashtezakonshem-per-ekonomine-shqiptare/
BURIMI	gazeta-shqip.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 19:33:05 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 22:12:11 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	44a3c1a34c248cb44d5a70b99cc357d8bb78d2daf74e275fbc962dc425b729b9
TEKSTI	3d06254a6ddaa04f59eaa2a2bf0814a952f7e3a9eaaa2e47b2d1d5208412b74a
PAMJA	f750c725c22650ea219decfe236522b90bdf70145934a1a924bb3e09ad1d3f67

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	cf76c768faad0c82c918314506d35bc1d73cfbf4bdc9539a4bd4fd8261133e0e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	20cb9bc098b6b22129b01f41a10ad3ad7e12cceb89fa0b5f21647847572e06c6
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/cf76c768faad0c82c918314506d35bc1d73cfbf4bdc9539a4bd4fd8261133e0e

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET

"Po studiojmë risqet që mund të sjellë në mjedis"/ Rama nga SHBA: Projekti i Sazanit dhe Zvërnecit, të jashtëzakonshëm për ekonominë shqiptare



21:12 | 26 SHTATOR 2026

SHPERNDA ▾

Kryeministri i vendit, Edi Rama ka folur sërish për projektin e Sazanit dhe Zvërnecit, duke i cilësuar si projekte të jashtëzakonshëm për ekonominë shqiptare. Gjatë fjalës se tij në një takim me komunitetin shqiptar në Staten Island, New York, Rama tha se Shqipëria po synon turizmin e vlerës, me qëllim sjelljen e më shumë përfitimeve ekonomike për popullin shqiptar.

Rama deklaroi se vetëm projekti në Zvërnec parashikohet të sjellë mbi 4 miliardë euro, duke theksuar se ekonomia shqiptare është rreth 27 miliardë euro. Më tej, ai theksoi se qeveria po studion edhe dëmin që këto projekte mund të sjellin në mjedis, duke hartuar një studim të plotë mbi risqet reale.

Edi Rama: *Këtë synim ka projekti i shumë diskutuar, projekti i famshëm, por edhe fatkeq për fat të keq, si rezultat i shumë gënjeshtreve, manipulimeve, denigrimeve. Projekti i Sazanit dhe Zvërnecit, një projekt që sjell vetëm në Zvërnec më shumë se 4 miliardë euro, në një ekonomi që në totalin e vet është 27 miliardë euro. Një projekt i jashtëzakonshëm për Shqipërinë. Është jashtëzakonisht delikat edhe në aspektin e ekuilibrit për mjedisin, prandaj ne po punojmë shumë për të pasur një studim për ndikimin dhe risqet në mjedis. Risqet reale dhe jo ato që prodhohen në rrjetet sociale nga sharlatanët e manipulatorët. Shpresoj që kur të vini në Shqipëri, kryepolici të na japë mundësi që të takohemi. Para se të vija këtu, më mori në telefon Dritani nga Mali i Zi, ish-kryeministri dhe miku im i shtrenjtë, i vetmi qytetar i botës në Ballkan, i cili më tha 'shiko se atje ku po shkon, te ajo dallqja shqiptare, ke edhe disa shkumë nga Ulqini. Kështu që shumë*

faleminderit.



GAZETA SHQIP

Rreth nesh

Marketing

Newsletter

Mundësi Punësimi

Kontakt

TOP ALBANIA RADIO

News

Shows

Video

Podcasts

MORE

Top Channel

TimeOutTirana

Top Music Awards

SOCIAL



Newsletter

Regjistrohu

[Privacy Policy & Terms of Use](#) | [Cookie Policy](#)

gazeta shqip

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.